



UNIVERSITETI MESDHETAR
SHQIPËRISË

NR. 144 PROT., DATË 02.02.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

NR. 160 PROT., DATË 02.02.2022

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

UNIVERSITETIT MESDHETAR TË SHQIPËRISË

DHE

INSTITUTIT TË STATISTIKAVE

TIRANË

MË DATË 02 / 02 /2022

UNIVERSITETI MESDHETAR TË SHQIPËRISË (UMSH), me adresë në Bulevardin “Gjergj Fishta”, nr. 52, 1023, Tiranë, përfaqësuar nga Prof. Dr. Adrian Civici, Rektori i UMSH,

dhe

INSTITUTI I STATISTIKAVE (INSTAT), me adresë në Rr. “Vllazën Huta”, Ndërtesa 35, Hyrja 1, 1017, Tiranë, përfaqësuar nga Znj. Elsa Dhuli, Drejtor i Përgjithshëm.

Duke qenë se Palët:

Njohin faktin që kjo marrëveshje përbën shprehje të vullnetshme të qëllimit midis palëve nënshkruese për të punuar së bashku për të promovuar efikasitetin e njohurive.

Synojnë që Marrëveshja të mbështesë një sërë aktivitetesh dhe të promovojet vendosjen e objektivave dhe procedurave të bashkëpunimit të ndërsjellë për shkëmbimin e materiale akademike dhe informacione të tjera duke respektuar parimin e konfidencialitetit dhe mirëbesimit.

Vlerësojnë se Marrëveshja krijon një kornizë dhe kushte të përgjithshme për bashkëpunimin efikas.

Marrin në konsideratë që Marrëveshja do të përforcojë, promovojet dhe zhvillojë bashkëpunimin e tyre reciprok, nëpërmjet kryerjes së praktikës profesionale të studentëve të UMSH pranë INSTAT.

Afimojnë vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të kësaj marrëveshje,

Kanë rënë dakord të lidhin këtë marrëveshje bashkëpunimi në vijim të quajtur Marrëveshje.

NENI 1
OBJEKTI

Palët e kësaj Marrëveshjeje, duke vepruar mbi bazën e dispozitave të saj si dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi, do të përpiqen të përforcojnë, promovojnë dhe zhvillojnë bashkëpunimin e tyre reciprok mbi bazën e barazisë dhe përfitimit të përbashkët në çdo fushë të kësaj marrëveshjeje.

NENI 2
BAZA LIGJORE

Kjo Marrëveshje bazohet në Ligjin nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM nr.177. datë 19.02.2009 “Për dhëni e lejes për hapjen e Institucionit “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë”.

NENI 3
FUSHAT E BASHKËPUNIMIT

1. INSTAT në kuadër të veprimtarisë së vet, do t'ju mundësojë studentëve të UMSH, kryerjen e praktikës profesionale të parashikuar në planin mësimor”, sipas kërkesës paraprake të dakordësuar ndërmjet palëve. Dinamika e realizimit të punës praktike do të përcaktohet me dokumentacion të veçantë që specifikon detyrimet e palëve për çdo grup praktike të çdo fakulteti të UMSH.
2. Ekpertë të INSTAT do të kenë mundësinë të mbajnë në UMSH leksione për promovimin e institucionit të tyre dhe të veprimtarisë së tij si dhe për rritjen e njohurisë së fushës statistikore tek studentët e UMSH.
3. UMSH do të aplikojë tarifa preferenciale për anëtarët e stafit të INSTAT të cilët do të ndjekin studimet në programet e studimit të UMSH, trajnimet apo aktivitetet kërkimore shkrençore.
4. Palët do të realizojnë veprimtari të përbashkëta kërkimore, promovuese dhe marketingu, me qëllim rritjen e cilësisë, imazhit të institucioneve respektive si dhe sensibilizimin e qytetarëve me projektet e përbashkëta të dy institucioneve.
5. Palët do të zhvillojnë forume të përbashkëta, konferanca shkencore, simpoziume, seminare, dhe shumë veprimtari të tjera të këtij lloji me interes reciprok.
6. Palët do të zhvillojnë veprimtari të përbashkëta promovuese dhe marketingu, me qëllim sensibilizimin e qytetarëve me projektet e përbashkëta të dy institucioneve.
7. Palët do të shkëmbejnë materiale akademike dhe informacione të tjera duke respektuar parimin e konfidencialitetit dhe mirëbesimit.

NENI 4
KUSHTET E BASHKËPUNIMIT

1. Kjo Marrëveshje nuk shoqërohet me detyrime apo impakt financiar ndërmjet palëve përveç rasteve kur palët bien dakort ndryshe.
2. Kostot dhe shpenzimet që lindin nga kjo Marrëveshje do të mbulohen nga secila palë me buxhetin e tyre.
3. Nëse nga bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve bazuar në parimet e mësipërme, lind nevoja për financimin e projekteve të përbashkëta, të dy institucionet do t'i rregullojnë këto raporte me anë të marrëveshjeve të veçanta financiare të cilat do të bazohen në parimet e bashkëpunimit të parashikuara në këtë Marrëveshje.
4. Të dy palët, në bazë të mundësive, mjeteve financiare që disponojnë dhe potencialit akademik e profesional, do të aplikojnë në organizma dhe institucionet e ndryshme për realizimin e projekteve të përbashkëta.
5. Rezultatet e këtij bashkëpunimi dhe përfitimet reciproke kur ato ekzistojnë bëhen publike vetem me aprovimin e të dy palëve. Palët ruajnë konfidencialitetin e informacioneve të

përsituara nga njëri-tjetri bazuar në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe legjislacionin për statistikat zyrtare.

NENI 5 **PERSONAT E KONTAKTIT**

Për tw zbatuar objektivat e shprehura më sipër palët mirëkuptohen dhe bien dakort në mënyrë reciproke për sa më poshtë:

1. Propozimet për bashkëpunim sipas kësaj marrëveshje do të paraqiten përmes personave të kontaktit të caktuar nga secili institucion.
- a) Për Universitetin Mesdhetar person kontakti është Z. Elton Skendaj, përfaqësues i Zyrës me Jashtë: e-mail: iro@umsh.edu.al
- b) INSTAT person kontakti është Znj. Irza Rroji, Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit Strategjik dhe Koordinimit, e-mail: irroji@instat.gov.al

NENI 6 **KOHËZGJATJA**

Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga Palët dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar.

NENI 7 **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHEVE**

7.1 Mosmarrëveshet midis palëve do të zgjidhen nëpërmjet frysë së mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre.

7.2 Në rast se nuk arrihet zgjidhja në këtë mënyrë, atëherë Marrëveshja konsiderohet e përfunduar dhe e zgjidhur për të gjitha efektet.

NENI 8 **DISPOZITA TË FUNDIT**

8.1 Megjithë sa është parashikuar në nenin 6, kjo marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë duke lajmëruar në formë të shkruar vullnetin për ndërprerjen e saj. Në këtë rast, Marrëveshja përfundon 30 (tridhjetë) ditë pas marrjes së këtij njoftimi.

8.2 Kjo marrëveshje hartohet në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, ku të gjithë tekstet janë njëloj të vlefshëm. Një kopje për secilën Palë.

Për INSTAT:

.....
Znj. Elsa Dhuli
DREJTORI PËRGJITHSHËM


Për UMSH:

.....
Prof. Dr Adrian Civici
REKTOR

